



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE

Nr. 992/16 Prot.

Tiranë, më 25.09.2019

URDHËR

Nr. 261, datë 25.09.2019

PËR KONTROLLUESIN "BASHKIA MALIQ"

Në mbështetje të neneve 29, 30 dhe 32 të ligjit nr.9887 datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar, neneve 77-112 të ligjit nr.44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", si dhe provave të administruara në ngarkim të kontrolluesit "Bashkia Maliq",

KONSTATOVA SE:

Në zbatim të Urdhrit nr.239 datë 27.08.2019 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, më datë 29.08.2019 u krye hetim administrativ pranë kontrolluesit "Bashkia Maliq", me objekt:

- Verifikim mbi ankesat e depozituara pranë Zyrës së Komisionerit me nr.990 Prot., datë 21.06.2019 nga _____ dhe nr.992 Prot., datë 21.06.2019 nga _____, mbi refuzimin e dhënies së informacionit dhe kopje të dokumenteve zyrtare, në kuadër të ligjshmërisë së përpunimit të të dhënave personale në zbatim të ligjit nr. 9887/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar dhe informacionit të prodhuar apo mbajtur nga autoritetet publike në zbatim të ligjit nr.119/2014 "Për të drejtën e informimit".

Inspektimi u iniciua bazuar në ankesat e dy qytetarëve, mbi pretendimet se ju është mohuar e drejta e aksesit në dokumentacionin e kërkuar pranë Bashkisë Maliq, mbi pronat e tyre.

Gjatë hetimit administrativ, është konstatuar se, lidhur me ankesat e nr. 990 prot., datë 21.06.2019 dhe _____ me nr. 992 prot. datë 21.06.2019, depozituar pranë Zyrës së Komisionerit, përfaqësuesit e Bashkisë Maliq kanë mbajtur qëndrimin se dokumentacioni i kërkuar nga ankuesit, nuk mund të vihet në dispozicion për

arsye se kjo praktikë është nën hetim nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Korçë, referuar shkresës me nr. 14/6 prot. datë 14.06.2019.

Shkresa e Prokurorisë, e regjistruar me nr.2729 prot. datë 18.06.2019 pranë Bashkisë Maliq, me lëndë "Urdhër thirrje e datës 14.06.2019", ka për objekt regjistrimin e procedimit penal 485/2019 për "Shpërdorim detyre" dhe paraqitjen e punonjësve të bashkisë të cilët janë thirrur nga prokuroria, por në shkresë nuk përmenden arsyet e për të cilën janë thirrur apo ndonjë element tjetër që mund të justifikojë mosvendosjen në dispozicion të dokumentacionit objekt ankese.

Me shkresën nr. 2906/1 datë 22.05.2019, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Korçë ka paraqitur Bashkisë Maliq, dy kërkesa për informacion të cilat konsistojnë në:

- I. A ka kërkesë nga "Xhengo Energji sh.p.k.", për heqjen nga fondi pyjor kullosor të sipërfaqeve që zënë objektet e Hec-it "Kasollet e Selcës". Nëse po, cila është koha dhe kur është/janë bërë kërkesat, çfarë masash janë marrë. Çfarë përgjigje i është dhënë shoqërisë konçensionare dhe në çfarë gjendje ndodhen këto pasuri mbi të cilat kjo shoqëri ka bërë kërkesë? Cilët janë punonjësit e bashkisë Maliq që janë marrë me këtë praktikë dhe cila është detyra e secilit prej tyre?
- II. Të vihet në dispozicion kopje e vërtetuar me origjinalin e gjithë praktikës që lidhet me kërkesën për heqje nga fondi pyjor kullosor i sipërfaqeve që zë ndërtimi i objektit konçesionar dhe pjesëve funksionale të tij, si dhe dokumente lidhur me gjendjen aktuale të këtyre pronësive.

Mbas verifikimit të dy shkresave të sipërcituara, grupi i kontrollit ka arritur në konkluzionin se nga ana e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Korçë, nuk rezulton të jetë caktuar ndonjë masë "kufizim aksesi" ose "masë sekuestro" në dokumentacionin / kontratën apo dokumentacionin e kërkuar nga ana e saj.

Bashkia Maliq ka refuzuar të vendosë në dispozicion të grupit të kontrollit dokumentacionin e kërkuar, sipas objektit të Urdhrit nr.239 datë 27.08.2019 të Komisionerit, pavarësisht komunikimit në rrugë zyrtare (shkresore) dhe bërjes me dije nga ana e inspektorëve të detyrimeve sipas ligjit nr. 9887/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar.

Në përfundim të hetimit administrativ, referuar provave dhe konstatimeve në vend, grupi i kontrollit hartoi procesverbalin përkatës i cili u nënshkrua edhe nga përfaqësuesit e Kontrolluesit / Autoritetit Publik, mbasi parashtruan komentimin se: "Shkeljet e konstatuara nga grupi i kontrollit nuk përbejnë shkelje administrative pasi nga Bashkia Maliq është respektuar ligji nr.119/2014 "Për të drejtën e informimit", neni 17, pika 2, gërma "b". Nga ana e Bashkisë Maliq janë vendosur në dispozicion shkresat zyrtare mbi procedimin penal me nr. 14/6 prot., datë 14.06.2019 e cila nuk është marrë parasysh nga grupi i kontrollit. Nga ana jonë do të paraqiten me shkrim kundërshtimet e këtij hetimi administrativ."

Në zbatim të neneve 87-89 të ligjit nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", kontrolluesi "Bashkia Maliq" është njoftuar të marrë pjesë në seancë dëgjimore pranë ambienteve të Zyrës së Komisionerit.

Kontrolluesi është paraqitur në seancë dëgjimore dhe ka paraqitur:

- Shkresën nr.3798 prot., datë 06.09.2019 drejtuar Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë në të cilën është paraqitur kërkesa për saktësim nëse procesi penal me nr. 485 viti 2019 i përket z.
- Shkresa nr. 5199 prot., datë 09.09.2019 e Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, e cila informon se pranë Prokurorisë është regjistruar procedimi penal nr. 485 viti 2019 për veprën penale "Shpërdorim detyre".
- Gjithashtu, kontrolluesi ka vënë në dispozicion nëpërmjet postës elektronike, pa e dërguar zyrtarisht sipas kërkesës së Zyrës së Komisionerit, dokumentacion jo të plotë dhe vetëm për njërin prej ankuesve.

Pas konsultimit të legjislacionit përkatës dhe dokumentacionit të administruar, Zyra e Komisionerit vlerëson se, argumentet e parashtruara nga Bashkia Maliq për mos vënien në dispozicion të dokumentacionit nuk qëndrojnë dhe nuk e justifikojnë mos garantimin e aksesit në dokumentacion të ankuesve.

Konkretisht, për Z. _____ nuk është vendosur në dispozicion:

- 1- Korrespondenca midis "Xhengo Energji sh.p.k." dhe Bashkisë Maliq;
- 2- Korrespondenca midis Bashkisë Maliq dhe Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Bashkia Maliq, që fillon nga data 18.01.2019 e në vijim;
- 3- Korrespondenca midis Bashkisë Maliq dhe DAMTP Qarku Korçë;
- 4- Dokumentacioni i plotë që ka lidhje me dosjen e pronës së z. Hoxhallari;
- 5- Dokumentacioni i plotë i komisionit të ngritur nga ana e Bashkisë Maliq për verifikimin e pronave të ankuesit;
- 6- Kontrata e qerasë e nënshkruar nga "Xhengo Energji sh.p.k." dhe Drejtoria e Shërbimit Pyjorë të Bashkisë Maliq;
- 7- Vendim heqje pezullimi mbas datës 02.04.2019, proces verifikues nga komisioni i ngritur nga Bashkia Maliq;
- 8- Shkresa drejtuar DAMTP së bashku me hartën shoqëruese të njëshuar me origjinalin;
- 9- Numrin e protokollit dhe kërkesën e Z. _____ për përgatitje të planit të rievimit;
- 10- Numrin e protokollit të depozitimit dhe deklaratën e datës 27.02.2019;
- 11- Numrin e protokollit dhe deklaratën e revokimit dërguar me shërbimin postar, kopje të shkresës nr.594/2 prot shkresë e AZHT, Bashkia Maliq.

Ndërkohë për Z. _____ nuk është vendosur në dispozicion:

- 1- Korrespondenca midis "Xhengo Energji sh.p.k." dhe Bashkisë Maliq;
- 2- Korrespondenca midis Bashkisë Maliq dhe Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Bashkia Maliq;

- 3- Korrespondenca midis Bashkisë Maliq dhe DAMTP Qarku Korçë;
- 4- Dokumentacioni i plotë i komisionit të ngritur nga ana e Bashkisë Maliq për verifikimin e pronave të ankuesit;
- 5- Kontrata e qerasë e nënshkruar nga "Xhengo Energji sh.p.k." dhe Drejtoria e Shërbimit Pyjor të Bashkisë Maliq;
- 6- Dokumentacioni i plotë që Bashkia Maliq posedon për HEC-Kasollet e Selcës.

Sa më sipër, në zbatim të neneve 12, 29, 30 pika 1, germa "b" dhe 32 të ligjit nr.9887/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Kontrolluesi "Bashkia Maliq", të garantojë të drejtën e aksesit për subjektet e të dhënave dhe , duke vendosur në dispozicion dokumentacionin e plotë, të kërkuar prej tyre, të njehsuar me origjinalin.
2. Kontrolluesi "Bashkia Maliq", të vendosë në dispozicion të subjekteve të të dhënave dhe , dokumentacionin e plotë të kërkuar prej tyre dhe të njehsuar me origjinalin, sipas shkresave me nr. 990/1 dhe 992/1 prot., datë 09.07.2019 të Zyrës së Komisionerit dhe identifikuar në përgjigje me shkresat me nr.3063/1 dhe 3061/1 prot., datë 17.07.2019 të Bashkisë Maliq, të cituara edhe në pjesën arësytuese të këtij Urdhri.
3. Kontrolluesi "Bashkia Maliq" të kryejë të gjitha detyrimet që burojnë nga ligji dhe nga ky akt, brenda një afati 5 ditor nga momenti i marrjes dijeni dhe të njoftojë me shkrim Zyrën e Komisionerit për masat e marra. Përbushja e këtyre detyrimeve nga kontrolluesi, përbën objekt kontrolli të vazhdueshëm nga Zyra e Komisionerit.
4. Në rast mos përbushje të detyrimeve të caktuara, Komisioneri vepron sipas nenit 30/2 dhe 39 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar. Komisioneri në rast shkeljesh serioze, të përsëritura ose të qëllimshme të ligjit nga një kontrollues ose përpunues, veçanërisht në rastet e përsëritura të moszbatimit të Urdhrave të tij, vendos sanksion me gjobë për kundërvajtjet administrative.

Ky urdhër u shpall sot më, 25.09.2019

KOMISIONERI

Besnik Dervishi